

Luan TETAJ

Instituti i Historisë “Ali Hadri”

Email: ltetaj@hotmail.com

ORCID: 0009-0000-3240-5115

KUD: 32:37.014.3(496.5)“18/19”(05)

IDETË ILUMINISTE TË NAUM VEQILHARXHIT**Abstrakt:**

Naum Veqilharxhi konsiderohej një nga figurat më të rëndësishme të iluminizmit shqiptar dhe një nga ideologët e parë të Rilindjes Kombëtare. I formuar intelektualisht në frymën e mendimit iluminist evropian, ai e kuptoi se emancipimi i kombit shqiptar nuk mund të arrihej pa arsimimin dhe zhvillimin e gjuhës amtare. Naum Veqilharxhi në vitin 1844 botoi në Rumani një vepër të shkurtër, por me ndikim të madh në zhvillimin e arsimit dhe të gjuhës shqipe: «Evëtorin», abetaren e parë të gjuhës shqipe. Një vite me vonë, më 1845, ai publikoi abetaren e tij të dytë, të titulluar “Fari i Ri - Evëtar Shqip për Djelm Nismëtarë”, e cila përfaqësonte një hap të rëndësishëm drejt përhapjes së arsimit shqip dhe edukimit themelor të brezave të rinj në lexim dhe shkrim në gjuhën amtare. Veqilharxhi mbështeste idenë se çdo komb i lirë nis rrugëtimin e tij përmes vetëdijes kulturore, duke ruajtur dhe promovuar gjuhën, zakonet dhe traditat autoktone, si themel të ndërtimit të një identiteti kombëtar dhe të qëndrueshëm. Si iluminist, Naum Veqilharxhi përfaqësonte lidhjen ndërmjet ideve përparimtare evropiane dhe nevojës për zgjim kombëtar në Shqipëri. Ai theksoi rëndësinë e vetëdijes kombëtare, të njohjes së historisë dhe kulturës së popullit shqiptar, si dhe të pavarësisë së mendimit intelektual e kulturor nga ndikimet e huaja. Në këtë mënyrë, ai hodhi themelet ideologjike të lëvizjes kombëtare, duke frymëzuar brezat pasues drejt përpjekjeve për arsimin, kulturën dhe mëvetësinë kombëtare.

Fjalë kyçe: Naum Veqilharxhi, Rilindja Kombëtare Shqiptare, Rumania, Evetari, arsimit.

Abstract:

Naum Veqilharxhi was considered one of the most important figures of the Albanian Enlightenment and one of the first ideologues of the National Renaissance. Intellectually formed in the spirit of European Enlightenment thought, he understood that the emancipation of the Albanian nation could not be achieved without education and the development of the mother tongue. In 1844, Naum Veqilharxhi published in Romania a short but highly influential work on the development of Albanian education and language: “Evëtorin”, the first primer of the Albanian language. A year later, in 1845, he published his second primer, entitled “Fari i Ri - Evëtar Shqip për Djelm Nismëtarë”, which represented an important step toward the dissemination of Albanian education and the basic education of new generations in reading and writing in the mother tongue. Veqilharxhi supported the idea that every free nation begins its journey through cultural consciousness, preserving and promoting its language, customs, and native traditions as the foundation for building a national and sustainable identity. As an Enlightenment thinker, Naum Veqilharxhi represented the connection between progressive European ideas and the need for national awakening in Albania. He emphasized the importance of national consciousness, knowledge of the history and culture of the Albanian people, and the independence of intellectual and cultural thought from foreign influences. In this way, he laid the ideological foundations of the national movement, inspiring successive generations toward efforts in education, culture, and national self-determination.

Keywords: Naum Veqilharxhi, Albanian National Renaissance, Romania, *Evëtari*, education.

Naum Panajot Bredhi i njohur si Veqilharxhi ishte një nga figurat më të ndritura dhe më përfaqësuese të shekullit XIX në historinë e popullit shqiptar. Naum Veqilharxhi (1797-1854) u lind në Vithkuq të Korçës, e njohur si qytezë me tregti të zhvilluar dhe me popullsi që e vlerësonte shumë arsimimin.¹ I njohur si patriot i madh, iluminist përparimtar, demokrat i shquar dhe mbi të

¹ Aleks Buda, *Shkrime Historike 2*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Shtëpia Botuese 8 Nëntori, Tiranë, 1986, f. 23; *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Vëllimi i tret: N-ZH, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Qendra Enciklopedike Shqiptare, Tiranë, 2009, f. 2872.

gjitha si ideologu i parë i lëvizjes shqiptare për çlirim kombëtar, Veqilharxhi u bë një nga nismëtarët kryesorë të Rilindjes Kombëtare Shqiptare

Pas përfundimit të Luftës Ruso-Osmane (1806-1812), Panajot Veqilharxhi dhe familja e tij u përballën me ndjekje dhe persekutime nga autoritetet osmane, të cilat ishin të lidhura ngushtë me dyshimet për bashkëpunimin e tij me trupat ruse gjatë rrethimit të qytetit të Izmailit.² Sipas dëshmimeve të Maries, bashkëshortes së tij, familja ishte persekutuar dhe përjetonte presion të vazhdueshëm politik dhe social. Në përpjekje për të shpëtuar nga persekutimi, Panajoti u detyrua të largohej nga vendlindja dhe gjeti strehim në Moldavi, në qytetin e Galacit, ku vendosi të merrej me tregti. Pas një periudhe të shkurtër, atij iu bashkua edhe familja, bashkëshortja dhe fëmijët e tij. Familja Veqilharxhi u vendos përfundimisht në Galac pas nënshkrimit të Traktatit të Paqes së Bukureshtit, dhe qëndroi aty deri në vitin 1821. Megjithatë, paqja nuk zgjati shumë. Në shkurt të vitit 1821, Moldavia u shndërrua në një fushëbetejë të hapur për shkak të shpërthimit të kryengritjes nacionalçlirimtare greke,³ e udhëhequr nga Aleksandër Ipsilanti,⁴ në kuadër të organizatës nacionalçlirimtare greke «Filiqi Eteria», që synonte të fuste në luftë kundër sundesve osmanë të gjithë popujt e nënshtruar të Ballkanit. Kjo kryengritje solli trazira të mëdha dhe një klimë të pasigurt për banorët e huaj dhe të lokalizuar në zonë. Familja Veqilharxhi, ashtu si shumë të tjerë, u përpoq me çdo mënyrë të shpëtonte nga pasojat e luftës dhe trazirat që ajo solli, duke u vendosur përkohësisht në vende më të sigurta.

Revolta që shpërtheu në Moldavi në shkurt të vitit 1821, si pjesë e kryengritjes nacionalçlirimtare greke e udhëhequr nga Aleksandër Ipsilanti, e gjeti familjen Veqilharxhi në një situatë jashtëzakonisht të vështirë. Pas një periudhe relative qetësie në qytetin e Galacit, ku Panajot Veqilharxhi

² Sulmi mbi Izmail gjatë luftërave ruso-turke (1806–1812) ishte një ndër episodet ushtarake më të rëndësishme në fushën jugore të konfliktit mes Perandorisë Ruse dhe Perandorisë Osmane. Ky sulm është veçanërisht i rëndësishëm për shkak të pozicionit strategjik të qytetit Izmail dhe përpjekjeve të përsëritura të rusëve për ta marrë atë gjatë luftërave të mëparshme, përfshirë rrethimin e famshëm të vitit 1790 nga Aleksander Suvorov. Izmaili ndodhet në Bregun jugor të lumit Danub, në rajonin historik të Besarabisë, që sot është pjesë e Ukrainës jugperëndimore, në kufi me Rumaninë (rajoni i Dobrukhës). Kjo zonë kishte rëndësi strategjike për kontrollin e rrjedhës së poshtme të Danubit dhe qasjen në Detin e Zi.

³ *Arkivi Qendror Shtetëror (AQSH)*, Fondi 826, Dosja 183, dok, Të dhëna të reja mbi personalitetin e shquar të lëvizjes nacionalçlirimtare shqiptare të shekullit XIX Naum Veqilharxhi, f. 5.

⁴ Aleksandër Ipsilanti ishte një Voivodë (Princ) Grek i Vllahisë.

ishte përpjekur të rindëronte jetën dhe të siguronte mirëqenien e familjes përmes tregtisë, shpërthimi i trazirave e detyroi atë dhe të afërmit e tij të shpërnguleshin sërish për të shpëtuar nga pasojat e luftës. Në një dëshmi prekëse të ruajtur nga bashkëshortja e tij, Maria Veqilharxhi, përshkruhet në mënyrë të ndjerë drama e shpërnguljes dhe vuajtjet që pasuan: *“Revolta që shpërtheu në Moldavi në vitin 1821 na detyruan të shpëtojmë në qarkun e Besarabisë, në qytetin Kishinjev, nën mbrojtjen e administratës së qetë perandorake, ku burri im, duke mos pasur në asnjë mënyrë për të ushqyer, ndërroi jetë”*.⁵ Ky rrëfim i shkurtër, por tronditës, hedh dritë mbi vështirësitë ekstreme me të cilat u përball familja. Shpërngulja drejt Besarabisë ishte për ta një përpjekje e dëshpëruar për të gjetur siguri dhe strehë. Megjithatë, kushtet e vështira të jetesës dhe mungesa e burimeve ekonomike e rënduan situatën deri në atë pikë sa Panajot Veqilharxhi, i privuar nga mundësia për të ushqyer familjen, humbi jetën në Kishinjev. Vdekja e tij në moshë të re dhe në rrethana kaq dramatike përbën një kapitull tragjik në jetën e familjes dhe në historinë e hershme të zgjimit kombëtar shqiptar. Kjo përvojë e dhimbshme do të linte një gjurmë të thellë jo vetëm në fatin e familjes, por edhe në mënyrën se si do të kujtohej më vonë figura e Panajot Veqilharxhit, jo vetëm si një përfaqësues i përpjekjeve kulturore e arsimore shqiptare, por edhe si një martir i një kohe të trazuar.

Kushtet materiale të jetesës së familjes Veqilharxhi në Besarabi, ashtu si edhe për mijëra emigrantë të tjerë shqiptarë të asaj kohe, kanë qenë jashtëzakonisht të vështira. Vështirësitë ekonomike ishin të mëdha dhe shqetësimi kryesor i përditshëm i tyre ishte sigurimi i bukës së gojës, për të përballuar jetesën minimale në një mjedis të huaj dhe shpesh të pasigurt. Mungesa e burimeve të qëndrueshme të të ardhurave dhe kushtet e vështira sociale e bënë jetën e mërgimtarëve shqiptarë tepër sfiduese. Sipas të dhënave dokumentare rumune, familja e Naum Veqilharxhit rezultoi të ketë qenë e vendosur në qytetin e Brailit që prej vitit 1832. Kjo dëshkohet në një sërë dokumentesh arkivore që konfirmojnë praninë e tij dhe të afërmit të tij në këtë qytet. Gjatë qëndrimit në Brail, Naum Veqilharxhi u angazhua fillimisht në veprimtari tregtare, duke ndjekur rrugën tradicionale të shumë mërgimtarëve shqiptarë të kohës, të cilët shpresonin të siguronin një jetë më të mirë përmes punës së ndershme dhe sipërmarrjes. Përveç aktivitetit tregtar, Veqilharxhi u përfshi

⁵ *AQSH*, Fondi 826, Dosja 183, dok, Të dhëna të reja mbi personalitetin e shquar të lëvizjes nacionalçlirimtare shqiptare të shekullit XIX Naum Veqilharxhi, f. 5.

edhe në fushën e drejtësisë, duke ushtruar praktikën e avokatisë, një fakt që dëshmon për nivelin e tij të lartë arsimor dhe intelektual, si dhe për interesin e tij të hershëm për çështjet shoqërore dhe ligjore.⁶ Pikërisht në këtë periudhë nisi të merrte një zhvillim figura e tij si iluminist dhe mendimtar përparimtar, i cili më vonë do të luajë një rol kyç në zgjimin kombëtar shqiptar.

I vendosur në këtë mjedis të ngarkuar me energji revolucionare dhe mendime progresist, Naumi u ndikua thellësisht nga zhvillimet që ndodhnin rreth tij. I pajisur me një formim të hershëm arsimor dhe me një horizont të hapur mendor, ai u përfshi në qarqet intelektuale dhe patriotike të kohës, duke përqaftuar me entuziazëm idealet e iluminizmit francez. Këto ide nuk i mori thjesht si frymëzim teorik, por i bëri pjesë të ndërgjegjes së tij politike e kombëtare, duke i shndërruar në mjet të reflektimit dhe veprimit për çështjen shqiptare. Naumi e kuptoi se çlirimi i popujve të Ballkanit nuk mund të arrihej vetëm me armë, por edhe me ndërgjegjësim shoqëror, me edukim, me përhapjen e dijes dhe të emancipimit politik e kombëtar. Prandaj, ai mishëroi një figurë të re të shqiptarit të epokës: jo thjesht luftëtar, por edhe iluminist, që e sheh lirinë si e drejtë universale dhe kombësinë si pasuri historike e kulturore që duhet zhvilluar përmes arsimit, kulturës dhe përfshirjes në botën moderne. Në këtë mënyrë, qëndrimi i tij në Brailë nuk ishte një periudhë pasive mërgimi, por një etapë e rëndësishme formimi intelektual dhe angazhimi politik, ku Naumi u shndërrua në një mbartës dhe përçues të ideve të reja evropiane në shërbim të një kauze kombëtare që do të merrte gjithnjë e më shumë formë në dekadat e mëvonshme.

Sa i përket kohës së saktë të shpërnguljes së familjes Veqilharxhi nga Besarabia drejt Vllahisë, mungojnë të dhënat e plota që mund të hedhin dritë për këtë moment të rëndësishëm. Megjithatë, duke u bazuar në kontekstin historik dhe zhvillimet e kohës, është e mundur që kjo shpërngulje të ketë ndodhur pas përfundimit të Luftës Ruso-Osmane dhe nënshkrimit të Traktatit të Paqes në Adrianopojë në vitin 1829.⁷ Ky traktat solli ndryshime të rëndësishme gjeopolitike në rajon dhe ndikoi në lëvizjet e popullsisë, përfshirë edhe mërgimin e shqiptarëve drejt territoreve më të sigurta dhe më të favorshme për jetesë në principatat danubiane.

Në fillim të shekullit XIX, qyteti i Brailës në Rumani ishte shndërruar në një nga qendrat më të rëndësishme të emigracionit ballkanik. Aty kishin

⁶Po aty, f. 11.

⁷Po aty.

gjetur strehë përfaqësues të popujve të ndryshëm nga rajon, grekë, bullgarë, serbë dhe shqiptarë të cilët, të shtyrë nga trysnia politike, shtypja osmane apo pamundësia për zhvillim ekonomik në atdhe, kishin emigruar për të kërkuar një jetë më të sigurt dhe më të denjë. Në këtë mjedis të larmishëm, shqiptarët, të cilët përbënin një pjesë të rëndësishme të kësaj pranije ballkanike, u integruan shpejt në jetën e qytetit, duke mbajtur lidhje të gjalla me atdheun, ndërsa gjithnjë e më tepër përfshiheshin në zhvillimet kulturore dhe politike të vendit pritës. Braila ishte edhe një vatër e mendimit të lirë dhe një fole e ideve revolucionare e anti-osmane. Në këtë qytet, në mesin e komuniteteve të mërguara, qarkullonin gjallërisht idetë iluministe evropiane, veçanërisht ato të Revolucionit Francez, liria, barazia, vëllazëria dhe sovraniteti i popujve, të cilat kishin gjetur terren në shoqëritë e shtypura të Ballkanit që kërkonin çlirim nga zgjedha perandorake dhe ringjallje kombëtare.⁸

Në kohën kur ndër popujt e tjerë të Ballkanit po ngrihej ndërgjegjja kombëtare dhe po merrte formë ideja e shtetit-komb, në Shqipëri ky proces historik u vonua për arsye të shumta dhe të ndërlikuara. Një ndër pengesat kryesore ishte gjendja e rëndë ekonomike dhe sociale e vendit, e cila kishte mbërthyer masat popullore në varfëri e nënshtrim. Përçarja fetare, e mbjellë e thelluar nga pushteti osman për të dobësuar unitetin kombëtar, kishte ndikuar në mënyrë të ndjeshme në fragmentarizmin e shoqërisë shqiptare dhe në pengimin e bashkimit të saj rreth një identiteti të përbashkët kulturor dhe gjuhësor. Përveç kësaj, mungesa e shkollës shqipe dhe ndalimi i përdorimit të gjuhës shqipe në jetën publike e në arsim, ishin faktorë thelbësorë që ngadalësuan ndërgjegjësimin kombëtar.⁹ Libri shqip ishte i rrallë, shpesh i ndaluar, dhe kultura shqiptare, e lënë jashtë institucioneve zyrtare, mbijetonte më shumë falë traditës gojore sesa përmes shkrimit e arsimit të organizuar. Kjo prapambetje në fushën e arsimit dhe kulturës e mbante popullin shqiptar në një errësi shpirtërore dhe intelektuale, duke e bërë të vështirë lindjen e një lëvizjeje të organizuar kombëtare.

Megjithatë, drita e iluminizmit filloi të depëronte edhe në këto vise të errësuar me shekuj nga sunduesit osmanë. Duke filluar nga vitet 30 të shekullit XIX, në skenën historike shqiptare filluan të shfaqen elementët e parë të borgjezisë së re, e cila, megjithëse e dobët dhe në formim e sipër, filloi të

⁸G. LL. Arsh, I. G. Senkeviç, N. D. Smirnova, *Histori e shkurtë e Shqipnisë...*, f. 29.

⁹Myslim Islamim, Naum Panajot Bredhi Veqilharxhi-Jeta veprimtaria dhe pikëpamjet e tija arsimore-kulturore dhe politike, Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Drejtoria e Studimeve dhe Botimeve Shkolllore, Tiranë, 1967, f. 10.

ndërgjegjësohej për rolin e saj në shoqëri. Kjo shtresë e re, e frymëzuar nga idetë e Rilindjes Evropiane dhe nga përvojat e popujve fqinjë që po ecnin drejt çlirimit dhe shtet formimit, filloi të kuptojë se pa përhapjen e arsimit, pa zhvillimin e gjuhës shqipe dhe pa krijimin e një kulture kombëtare nuk mund të ketë as liri, as përparim dhe qytetërim.

Pikërisht në këtë frymë rilindëse e iluministe, disa përfaqësues të përparuar të mendimit shoqëror shqiptar ngritën zërin për domosdoshmërinë e emancipimit të kombit. Ata e kuptuan se çështja kombëtare nuk ishte vetëm një çështje politike, por një çështje e thellë kulturore dhe arsimore. Ndër këto figura, një ndër më të shquarit ishte Naum Veqilharxhi, dhe një plejadë e tërë e shqiptarëve që jetonin kryesisht jashtë atdheut të cilët e kuptuan me qartësi se zgjimi kombëtar i shqiptarëve duhej të fillonte me lëvrimin dhe përhapjen e gjuhës shqipe. Ai formuloi një platformë të qartë dhe të guximshme për kohën, duke u përpjekur të krijojë një alfabet shqip dhe të hartojë tekstet e para për shkollat shqipe, si një hap i domosdoshëm drejt ndërtimit të vetëdijes kombëtare.¹⁰ Veqilharxhi, si një iluminist i vërtetë,¹¹ nuk e pa përparimin thjesht si zhvillim ekonomik apo politik, por si një ngritje shpirtërore dhe intelektuale të popullit. Për të, arsimi, dija dhe kultura ishin themeli mbi të cilin duhej të ndërtohej liria dhe e ardhmja e kombit shqiptar. Veprat e tij dhe përpjekjet e rilindësve që e pasuan, shënuan fillimin e një epoke të re për shqiptarët, epokën e Rilindjes Kombëtare.

Naum Veqilharxhi ishte i pari që artikuloi kërkesat e reja kombëtare përmes një këndvështrimi iluminist.¹² Në vitet 1836 ai iu drejtua bashkatdhetarëve shqiptarë përmes letrës së tij të njohur «Enciklike»,¹³ duke theksuar qartë domosdoshmërinë historike të zgjimit kombëtar dhe nevojën për përparim shoqëror e kulturor. Përmes këtyre fjalëve: *“Ka ardhur koha që t’i flakim gjithë paragjykimet e vjetërsuara, ka ardhur koha të çohemi e të mundohemi me pjekuri dhe guxim, të këmbejmë udhë, duke marrë këtej e tutje si shembull kombet e përparuara mbi tokë dhe kështu një ditë edhe ne, me dëshirën e zo-*

¹⁰ Stefanaq Pollo, “Mbi disa aspekte ideologjike e politike të Rilindjes Kombëtare Shqiptare”, Studime Historike, Viti XXII (V) 1, Universitetin Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1968, f. 87; Myslim Islamim, Naum Panajot Bredhi Veqilharxhi-Jeta veprimtaria dhe pikëpamjet e tija arsimore-kulturore dhe politike..., f. 10.

¹¹ Aleks Buda, *Shkrime Historike, Publicistike 4*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Botime Toena, Tiranë, 2000, f. 372.

¹² *Historia e Popullit e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, Vëllimi I, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Botime Albanologjike, Tiranë, 2022, f. 60.

¹³ G. LL. Arsh, I. G. Senkeviç, N. D. Smirnova, *Histori e shkurtë e Shqipërisë...*, f. 89.

tit, shpresojmë të rreshtohemi në serën e kombeve të qytetëruara. Dhe duke synuar këtë le të ecim pa u lëkundur me guxim dhe me këmbëngulje...”.¹⁴

Përmes letrës “*Enciklike*”, Naum Veqilharxhi synon të evidentojë dhe të analizojë në mënyrë të thelluar shkaqet e prapambetjes së popullit shqiptar dhe gjendjen tepër të rënduar të atdheut të tij në atë periudhë historike. Ai nuk mjaftohet vetëm me një përshkrim të situatës, por përpiket të ndërgjegjësojë bashkëkombësit e vet mbi arsyet që kanë çuar në këtë gjendje, duke vënë në dukje mungesën e arsimit në gjuhën amtare, ndikimin e paragjytimeve dhe zakoneve të vjetra, si dhe mungesën e një vetëdijeje të qartë kombëtare. Veqilharxhi e sheh këtë krizë jo vetëm si pasojë të faktorëve të jashtëm, por edhe si rezultat të mos angazhimit të brendshëm për ndryshim dhe përparim. Në këtë kontekst, letra e tij merr vlerën e një thirrjeje për reformim mendësie, për zgjim shpirtëror dhe për ndërtimin e një shoqërie më të arsimuar, më të vetëdijshme dhe më të bashkuar rreth idealeve kombëtare.

Ky pozicion filozofik i Veqilharxhit merr një rëndësi të veçantë kur vendoset në kontekstin historik të shek. XIX, kur bota shqiptare vuante ende pasojat e një periudhe të gjatë të sundimit të huaj. Në këtë periudhë, mendimi kritik dhe arsyeja ishin lënë në harresë, të zëvendësuara nga autoriteti absolut i dogmave fetare. Kjo ishte një kohë kur njeriu nuk inkurajohej të mendonte vetë, por të bindja pa diskutim ndaj autoriteteve shpirtërore dhe pushteteve sunduese.

Në këtë kuadër, thirrja e Veqilharxhit për t’u kthyer te arsyeja është në vetvete një akt revolucionar, është një hap i guximshëm drejt ndriçimit intelektual e përparimit shoqëror. Duke i dhënë arsyes një vend të privilegjuar në procesin e njohjes, Veqilharxhi lidhet drejtpërdrejt me mendimtarët racionalistë të iluminizmit francez, të cilët e trajtonin arsyen si dritën udhëheqëse të njeriut në rrugën drejt lirisë, drejtësisë dhe dijes. Njësoj si ata, edhe ai besonte se vetëm përmes arsimit dhe zhvillimit të mendimit kritik mund të çlirohej njeriu nga errësira e injorancës dhe e robërisë shpirtërore. Prandaj, në dritën e këtyre ideve, mund të themi me bindje se Naum Veqilharxhi është jo vetëm një figurë themelore e mendimit arsimdashës, por edhe një ndër racionalistët e parë të mirëfilltë të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Me theksin që i vendos arsyes si themel i njohjes dhe përparimit, ai i hap rrugën një epoke të re në historinë shqiptare, epokës së ndriçimit, vetëdijesimit dhe

¹⁴ Myslim Islami, *Naum Panajot Bredhi Veqilharxhi-Jeta veprimtaria dhe pikëpamjet e tija arsimore-kulturore dhe politike...*, f. 63.

emancipimit kombëtar që pretendohej të rezultojë me lirinë dhe formimin e shtetit kombëtar.

Naum Veqilharxhi i kushtoi një rëndësi të veçantë zhvillimit të mendimit pedagogjik shqiptar në gjysmën e dytë të shekullit XIX, duke kontribuar ndjeshëm në ngritjen e tij mbi baza më të përparuara në krahasim me mendimet pedagogjike të shek. XVIII. Pedagogjia shqiptare në periudhën e Rilindjes nuk ishte thjesht një disiplinë arsimore, por një mjet i fuqishëm në funksion të çlirimit shpirtëror dhe politik të kombit. Në këtë kontekst, Veqilharxhi doli në mbështetje të shkollës laike, duke qenë një mbrojtës i vendosur i arsimimit të lirë dhe të pavarur nga ndikimet fetare dhe të huaja.¹⁵ Ai e konsideronte shkollën jo vetëm si vendin ku mësohet leximi e shkrimi, por si institucionin themelor për ndërtimin e vetëdijes kombëtare, zhvillimin e mendimit kritik dhe edukimin e brezave me ndjenjën e përkatësisë kombëtare. Nëpërmjet përpjekjeve të tij për hartimin e abetareve dhe përhapjen e mësimin në gjuhën shqipe, Veqilharxhi e shndërroi arsimin në një akt politik e kulturor, duke e çuar më tej frymën iluministe dhe duke ndikuar drejtpërdrejt në formimin e një pedagogjie kombëtare përparimtare, e cila do të shërbente si themel për ndërtimin e shtetit dhe shoqërisë moderne shqiptare.

Në frymën e mendimtarëve iluministë evropianë, që besonin se arsimi dhe dija janë rrugët e vetme për përparim dhe liri, Naum Veqilharxhi artikuloi vizionin e tij për një shkollë të re shqiptare, një shkollë që të mos ushqente përçarje fetare apo varësi të huaja, por që të niste nga gjuha amtare si themel i natyrshëm i edukimit dhe vetëdijes kombëtare. Argumenti i vetëm që mund t'i bashkonte shqiptarët rreth identitetit të përbashkët ishte interesi kombëtar, kurse ndarja krahinore, dialektore e sidomos dallimet religjioze ishin faktorë që do t'i thellonin dallimet, përçarjet dhe mospajtimet midis tyre. Në kushtet e një Shqipërie të prapambetur në fushën e arsimit dhe nën trysinë e strukturave të huaja administrative, fetare dhe kulturore, hapi i parë drejt këtij qëllimi fisnik ishte hartimi i abetares, themeli i çdo sistemi arsimor kombëtar. Por para se të hartohej një abetare e mirëfilltë, duhej ndërtuar një alfabet i posaçëm, i cili të përfaqësonte me saktësi tingujt e gjuhës shqipe dhe të ishte i lirë nga ngarkesat ideologjike të alfabeteve të huaja. Deri atëherë, për shkrimin e shqipes ishin përdorur alfabetet latine, greke dhe arabe, të cilat, përveçse të papërshtatshme për strukturën fonetike të shqipes, ishin ngarkuar me simbolikë fetare dhe kishin shërbyer si mjet për përhapjen e ndikimeve të huaja

¹⁵ Myslim Islami, *Naumi Veqilharxhi*, 8 Nëntori, Tiranë, 1977, f. 15-16.

politike. Veqilharxhi, me vizionin e tij iluminist dhe racionalist, e kuptoi se këto alfabetë nuk mund të shërbenin si bazë për ndërtimin e një kulture të përbashkët kombëtare.¹⁶ Ato jo vetëm që nuk e përfaqësonin plotësisht gjuhën e popullit shqiptar, por edhe thellonin përçarjet në një komb të fragmentuar tashmë nga besimet fetare dhe ndikimet e jashtme.

Naum Veqilharxhi ndërmori një nga nismat më të rëndësishme kulturore të shekullit XIX, ndërtimin e një alfabeti të ri për gjuhën shqipe. Qysh në vitet 1820, ai nisi punën për krijimin e këtij alfabeti, duke u frymëzuar pjesërisht nga sistemet ekzistuese të shkrimit si latinishtja, greqishtja dhe alfabeti arab, por duke i përpunuar e përshtatur në mënyrë origjinale, me synimin që ky sistem të pasqyronte me saktësi tingullin e shqipes dhe të ishte i pavarur nga ndikimet fetare apo politike të huaja.¹⁷ Me këtë alfabet të ri, Veqilharxhi hartoi disa tekste mësimore, të cilat ishin rezultat i një pune të gjatë intelektuale dhe pedagogjike. Megjithatë, për shkak të kushteve të vështira teknike të kohës, mungesës së mbështetjes financiare dhe mjeteve të duhura për botim, këto tekste mbetën të pabotuara për afro dy dhjetëvjeçarë. Ato jetuan si dokumente të heshtura të një vizioni të madh, që priste kohën e vet për të dalë në dritë.

Ky vizion u konkretizua për herë të parë më 1844, kur Veqilharxhi botoi në Rumani një vepër të vogël, por me rëndësi të jashtëzakonshme për historinë e arsimit dhe të gjuhës shqipe: “*Evëtori*”, abetaren e parë të gjuhës shqipe.

Kjo abetare, e shtypur me mjete të thjeshta poligrafike, përfaqëson një akt themelues në përpjekjen për të ngritur një sistem arsimor kombëtar, të ndërtuar mbi gjuhën amtare dhe përmes një metode pedagogjike të thjeshtë, të kuptueshme dhe të lirë nga ndikimet ideologjike.¹⁸ “*Evëtori*” nuk ishte thjesht një mjet mësimor, ai ishte një manifest kulturor, një thirrje për vetëdijesim kombëtar dhe një shprehje konkrete e idealit iluminist: që dija, arsimi dhe gjuha amtare janë themeli mbi të cilin ndërtohet liria dhe qytetërimi i një kombi. Në një kohë kur shqiptarët ishin ende të ndarë në besime, krahinë e

¹⁶ Aleks Buda, *Shkrime Historike 2...*, f. 24; *Historia e Popullit Shqiptar II, Rilindja Kombëtare vitet 30 të shek. XIX-1912*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Botime Toena, Tiranë, 2002, f. 99.

¹⁷ Po aty.

¹⁸ Po aty; *AQSH*, Fondi 826, Dosja 183, dok, Të dhëna të reja mbi personalitetin e shquar të lëvizjes nacionalçlirimtare shqiptare të shekullit XIX Naum Veqilharxhi, f. 12; Edwin E. Jacques, *The Albanians, An Ethnical History from Prehistoire Times to the Present*, McFarland & Company, Inc., Publishers Box 611, Jefferson, North Carolina 18640, 2009, f. 283.

interesa të ndryshme, kjo abetare erdhi si një fener i ndritshëm për bashkimin kulturor dhe për zgjimin e ndërgjegjes kombëtare.

Abetarja e Veqilharxhit, kjo vepër modeste në formë por madhështore në përmbajtje dhe qëllim, nuk mbeti vetëm një akt simbolik. Pas botimit të saj më 1844 në Rumani, ajo nisi të shpërndahej me kujdes dhe vendosmëri në disa prej krahinave më të gjalla të Shqipërisë së Jugut: në Korçë, Përmet, Berat, Gjirokastër e më gjerë.¹⁹ Në këto treva, ku ndikimi i shkollave të huaja po rrezikonte të zëvendësonte trashëgiminë shpirtërore e gjuhësore shqiptare, abetarja u prit si një rreze drite, një shpresë për ringjalljen e vetëdijes kombëtare dhe një mjet konkret për të filluar edukimin në gjuhën e mëmës.

Botimi dhe shpërndarja e saj ngjalli entuziazëm të madh ndër bashkatdhetarët, veçanërisht te rrethet intelektuale dhe patriotike, të cilat e kishin kuptuar rëndësinë jetike të arsimit në gjuhën shqipe për mbijetesën kulturore dhe politike të kombit. Ky entuziazëm nuk ishte thjesht ndjenjë, por mori trajta konkrete: organizime të vogla për mësim në gjuhën shqipe, përpjekje për lexim e shkrim sipas alfabetit të Veqilharxhit, dhe ndarje e abetares në mënyrë të fshehtë, për t'iu shmangur kontrollit të autoriteteve osmane dhe ndikimeve të huaja. Në këtë akt të shpërndarjes së abetares dhe në përgjigjen që ajo mori, reflektohet në mënyrë të qartë shpirti iluminist i kohës: besimi se dija dhe arsimi janë forca çliruese, se përparimi nuk vjen nga përujja, por nga vetëdija, dhe se çdo komb i qytetëruar duhet të nisë ngritjen e tij mbi themelet e gjuhës, kulturës dhe arsyes së vet. Për bashkëkohësit e Veqilharxhit, kjo abetare nuk ishte vetëm një libër për të mësuar të lexuarin, ajo ishte “libri i parë i lirisë”, gurthemeli mbi të cilin duhej të ngrihej ndërgjegjja kombëtare shqiptare.

Në vitin 1845, ai botoi abetaren e tij të dytë me titull “*Fari i Ri-Evetar Shqip për Djelm Nismëtarë*”, një vepër e rëndësishme e cila përfaqësonte një përpjekje të re për përhapjen e arsimit në gjuhën shqipe dhe për formimin bazë të brezit të ri në lexim e shkrim.²⁰ Autori bënte thirrje për shpërndarjen e saj në të gjithë trevat shqiptare, nga Manastiri, Korça, Kolonja, Përmeti, Berati, Vlora, Çamëria, Himara, Gjirokastra, Zagoria, Tepelena, Elbasani e deri

¹⁹ Nathalie Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar. Lindja e një kombi me shumicë myslimane në Evropë*, Marin Barleti, Tiranë, 2000, f. 166; *AQSH*, Fondi 826, Dosja 183, dok, Të dhëna të reja mbi personalitetin e shquar të lëvizjes nacionalçlirimtare shqiptare të shekullit XIX Naum Veqilharxhi, f. 12.

²⁰ *AQSH*, Fondi. 39, Dosja 3, f. 55; Naum P. Veqilharxhi, *Fari i Ri Evetar Shqip për Djelm Nismëtorë*, Mot i dytë, 1845, Akademia e Shkencave e RPSSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1984.

në gjithë Gegërinë,²¹ duke synuar përhapjen e dijes dhe vetëdijes kombëtare në mbarë hapësirën shqiptare.

Në një letër dërguar nipit të tij Calit, Naum Veqilharxhi shprehu bindjen e tij të thellë, në frymën e ideve iluministe të kohës, se kombi shqiptar tashmë kishte hyrë në një fazë të re të vetëdijes kombëtare dhe të formimit si një trup i unifikuar kulturor e gjuhësor. Ai theksonte se ishte momenti i duhur që të gjithë shqiptarët atdhetarë, si brenda trojeve amtare ashtu edhe në mërgatë, të bashkoheshin për të ndihmuar në zhvillimin, forcimin dhe përparimin e mëtejshëm të kombit. Kjo thirrje mbarte jo vetëm një ndjesi urgjence për ruajtjen e identitetit kombëtar përmes gjuhës dhe arsimit, por edhe një vizion të qartë për rolin që secili shqiptar duhej të kishte në projektin e madh të rilindjes kombëtare.²²

Naum Veqilharxhi, si një nga mendimtarët e parë më të shquar të rilindjes kombëtare shqiptare, bënte thirrje të hapur për angazhim të gjithanshëm në dobi të çështjes shqiptare, e cila në atë kohë kishte nevojë të ngutshme për mbështetje, ndërgjegjësim dhe kontribut intelektual.²³ Ai besonte thellësisht se përparimi i një kombi nuk ishte i rastësishëm, por fryt i një pune të vazhdueshme për ndërtimin e identitetit kulturor, arsimor dhe moral. Duke u mbështetur në frymën iluministe evropiane, ai kërkonte që shqiptarët të hiqnin dorë nga ndikimet dhe frymëzimet antikombëtare, të huaja dhe të dëmshme, dhe t'i përkushtoheshin në mënyrë të vetëdijshme misionit për ndërtimin e një kulture kombëtare të fortë, të bazuar në gjuhën, zakonet dhe traditat autoktone shqiptare. Sipas tij, të gjitha kombet që sot gëzojnë liri dhe forcë, e kanë nisur rrugëtimin e tyre përmes vetëdijes kulturore dhe formimit të ndërgjegjes kombëtare. Prandaj, edhe shqiptarët duhet të ndërmarrin pavyonesë këtë rrugë të gjatë dhe të vështirë, por të lavdishme, drejt ndërtimit të një të ardhmeje të qëndrueshme. Kombi shqiptar, si çdo komb tjetër në Evropë, ishte formuar natyrshëm, i vendosur në një territor të caktuar, me gjuhën e vet, me zakone dhe kulturë të veçantë, dhe për këtë arsye meritonte të jetonte i lirë, i bashkuar dhe i organizuar në një shtet të pavarur.²⁴ Sipas

²¹ Naum P. Veqilharxhi, *Fari i Ri Evetar Shqip për Djelm Nismëtorë*, Mot i dytë, 1845..., f. 1.

²² *AQSH*, Fondi, 39, Dosja 2; Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të shtetit, Rilindja Kombëtare Shqiptare Vëllimi I (Katallog i materialeve dokumentare të fondeve personale), Tiranë, 1976, f. 26; Nathalie Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar. Lindja e një kombi me shumicë myslimane në Evropë...*, f. 167.

²³ Aleks Buda, *Shkrime Historike 3*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Botime Toena, Tiranë, 2002, f. 313-314.

²⁴ *AQSH*, Fondi, 39, Dosja 2; Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të shtetit..., f. 26.

Veqilharxhit, çlirimi i tij nuk duhej të ishte thjesht politik, por edhe shpirtëror, kulturor dhe arsimor, një çlirim që fillon nga vetëdija dhe ndërgjegjia për atë që jemi dhe për atë që duhet të bëhemi.

Naum Veqilharxhi, në përpjekjet e tij për të përhapur ndriçimin kulturor dhe ndërgjegjen kombëtare ndër shqiptarët, vendosi lidhje edhe me koloninë arbëreshe të Italisë, e cila përfaqësonte një vatër të rëndësishme të ruajtjes së gjuhës, kulturës dhe kujtesës historike shqiptare.²⁵ Në qendër të këtyre kontakteve ishte figura e shquar e Jeronim De Radës, një prej përfaqësuesve më të njohur të romantizmit arbëresh dhe të lëvizjes për ringjalljen kombëtare.²⁶

Përmes këtyre marrëdhënieve, u krijua një urë shpirtërore dhe intelektuale mes shqiptarëve të brendshëm dhe diasporës arbëreshe, e cila kishte ruajtur për shekuj me përkushtim identitetin e saj. Në botimet dhe korrespondencën e arbëreshëve u shkrua me entuziazëm për suksesin dhe jehonën që pati *Evetari* i Naumit, një abetare që për herë të parë i ofroi popullit shqiptar mundësinë për të mësuar gjuhën amtare me alfabet të posaçëm dhe në një frymë kombëtare. Nëpërmjet këtyre lidhjeve, Veqilharxhi u bëri thirrje arbëreshëve të kontribuonin në mënyrë aktive për rilindjen e atdheut të tyre të origjinës, Shqipërisë duke ndihmuar në zhvillimin e arsimit dhe forcimin e vetëdijes kombëtare.

Ideali iluminist i Veqilharxhit qëndronte mbi bindjen se arsimit në gjuhën amtare ishte themeli i çdo ndryshimi të qëndrueshëm, si në aspektin shoqëror, ashtu edhe në atë politik. Sipas tij, vetëm përmes përhapjes së diturisë dhe edukimit në gjuhën shqipe, populli shqiptar do të arrinte të çlirohej nga errësira e padijes dhe të afirmohej si një komb i qytetëruar e i barabartë me të tjerët në Evropë. Këto ide, që në thelb përfaqësonin një sintezë ndërmjet iluminizmit perëndimor dhe realitetit shqiptar, u përqaftuan dhe u trashëguan nga brezi i ri i ideologëve të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Ata panë në Veqilharxhin jo vetëm një mësues të popullit, por edhe një pararendës vizionar, që i dha kombit mjetin më të fuqishëm për t'u formuar, gjuhën dhe arsimin në shërbim të identitetit kombëtar.

²⁵ Luan Tetaj, "Pikëpamjet iluministe dhe shqiptaret gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare", Revista Kosova, nr. 47, Instituti i Historisë "Ali Hadri", Prishtinë, 2022, f. 84.

²⁶ Ismet Dermaku, *Paraqitja e Naum Veqilharxhit dhe rëndësia e veprimtarisë së tij iluministe e patriotike (1797-1854, Rilindja Kombëtare Shqiptare dhe Kolonit Shqiptare të mërgimit në Rumani dhe në Bullgari*, Prishtinë, 1986, f. 67.

Përfundime

Naum Veqilharxhi përfaqëson një nga figurat më vizionare dhe progresive të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, duke luajtur një rol kyç në formimin e vetëdijes moderne kombëtare. Ai ishte intelektual i parë shqiptar që, në mënyrë të vetëdijshme dhe të strukturuar, artikuloi konceptin e kombit dhe të gjuhës shqipe mbi bazën e parimeve të Iluminizmit evropian, duke i dhënë lëvizjes shqiptare një orientim racional dhe modern. Për Veqilharxhin, arsimit dhe dija nuk ishin thjesht mjete praktike, por instrumente të çlirimit shpirtëror dhe të konsolidimit të vetëdijes kombëtare, si dhe të ndërtimit të dinjitetit të përbashkët. Naum Veqilharxhi e konceptoi kombin shqiptar si një tërësi organike, ku besimi, krahinat dhe statusi shoqëror nuk duhej të ishin pengesë për unitetin. Në këtë perspektivë, shqiptarët përbëjnë një trup të vetëm kombëtar, i cili duhej të ndërjegjësohej për identitetin dhe të bashkonte kulturën dhe gjuhën. Gjuha shqipe ishte për Veqilharxhin mjete kryesor i këtij bashkimi, një simbol i vetëdijes kombëtare që duhej të mbrohej, përhapet dhe të përdorej si themel i arsimit dhe i qytetërimit shqiptar. Përmes veprës dhe mendimit iluminist ai hodhi bazat e një mendimi politik modern, ku kombi shihej si produkt i kulturës, dijes dhe ndërjegjëses, dhe jo thjesht trashëgimi biologjike apo fetare. Në këtë kuptim, Veqilharxhi mund të konsiderohet pararendës i ideologjisë kombëtare shqiptare dhe një nga intelektualët më të rëndësishëm të Rilindjes, i cili synoi të ndërtonte një komb modern në frymën e qytetërimit evropian.

Bibliografi:

Burimet arkivore:

- *Arkivi Qendror Shtetëror (AQSH)*, Fondi 826, Dosja 183, dok, Të dhëna të reja mbi personalitetin e shquar të lëvizjes nacionalçlirimtare shqiptare të shekullit XIX Naum Veqilharxhi.
- *AQSH*, Fondi, 39, Dosja 2; Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave të shtetit, Rilindja Kombëtare Shqiptare Vëllimi I (Katallog i materialeve dokumentare të fondeve personale), Tiranë, 1976.
- *AQSH*, Fondi. 39, Dosja 3.

Monografi & Punime shkencore:

- Buda, Aleks, *Shkrime Historike 2*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Shtëpia Botuese 8 Nëntori, Tiranë, 1986.
- Buda, Aleks, *Shkrime Historike 3*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Botime Toena, Tiranë, 2002.
- Buda, Aleks, *Shkrime Historike, Publicistike 4*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Botime Toena, Tiranë, 2000.
- Dermaku, Ismet, *Paraqitja e Naum Veqilharxhit dhe rëndësia e veprimtarisë së tij iluministe e patriotike (1797-1854, Rilindja Kombëtare Shqiptare dhe Kolonit Shqiptare të mërgimit në Rumani dhe në Bullgari*, Prishtinë, 1986.
- Edwin E. Jacques, *The Albanians, An Ethnic History from Prehistoire Times to the Present*, McFarland & Company, Inc., Publishers Box 611, Jefferson, North Carolina 18640, 2009.
- *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Vëllimi i tret: N-ZH, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2009.
- G. LL. Arsh, I. G. Senkeviç, N. D. Smirnova, *Histori e shkurtë e Shqipnisë*, Rilindja, Prishtinë, 1967.
- *Historia e Popullit e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, Vëllimi I, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Botime Albanologjike, Tiranë, 2022.
- *Historia e Popullit Shqiptar II, Rilindja Kombëtare vitet 30 të shek. XIX-1912*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Botime Toena, Tiranë, 2002.
- Islami, Myslim, *Naum Panajot Bredhi Veqilharxhi-Jeta veprimtaria dhe pikëpamjet e tija arsimore-kulturore dhe politike*, Ministria e Arsimit dhe

- Kulturës, Drejtoria e Studimeve dhe Botimeve Shkollore, Tiranë, 1967.
- Islami, Myslim, *Naumi Veqilharxhi*, 8 Nëntori, Tiranë, 1977.
- Nathalie Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar. Lindja e një kombi me shumicë myslimane në Evropë*, Marin Barleti, Tiranë, 2000.
- Naum P. Veqilharxhi, *Fari i Ri Evetar Shqip për Djelm Nismëtorë*, Mot i dytë, 1845, Akademia e Shkencave e RPSSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1984.
- Pollo, Stefanaq, “*Mbi disa aspekte ideologjike e politike të Rilindjes Kombëtare Shqiptare*”, Studime Historike, Viti XXII (V) 1, Universitetin Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1968.
- Tetaj, Luan, “*Pikëpamjet iluministe dhe shqiptaret gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare*”, Revista Kosova, nr. 47, Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë, 2022.

Luan TETAJ

The Institute of History “Ali Hadri”

Email: ltetaj@hotmail.com

ORCID: 0009-0000-3240-5115

KUD: 32:37.014.3(496.5)“18/19”(05)

SUMMARY**ENLIGHTENMENT IDEAS OF NAUM VEQILHARXHI**

Naum Veqilharxhi represents one of the most emblematic and progressive figures of the ideology of the Albanian National Awakening. He is the first intellectual to clearly and consciously articulate an Enlightenment-based concept of the nation, the homeland, and the national language, thus giving the Albanian movement a foundation rooted in modern European thought. Inspired by the Enlightenment ideas spreading across Europe in the 18th–19th centuries, Veqilharxhi deeply understood the transformative role of reason, knowledge, and education as instruments for the spiritual and political emancipation of peoples. In his conception, the Albanian nation constituted the entirety of all Albanians regardless of religion, region, or social status a community that had to be built upon the foundations of language, culture, and national consciousness. He was the first to conceive of the Albanian language as the fundamental unifying element of the Albanian people, elevating it to the level of a symbol of identity and national awareness. Through his work and thought, Naum Veqilharxhi provided the Albanian national movement with a distinct ideological, cultural, and educational dimension, transforming it into a conscious project of national awakening. In this sense, he may be regarded as a forerunner of modern Albanian political thought and as one of the founders of the ideology of the nation-state in the Enlightenment understanding of the term.